



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

KOMUNA E RAHOVECIT

Nr. i prot. 4617 Më 05.11.2020
Br. prot. Dt.

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

RAHOVEC - ORAHOVAC

KONTRATA

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **“PLURAL” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Albin Thaqi & “ARBOR GROUP” Sh.p.k. me adresë në Kamenicë, të cilën e përfaqëson Granit Berisha & “Pro & Co Group” Sh.p.k. me adresë në Viti, të cilën e përfaqëson Kenan Emini**

janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS: VAZHDIMI I RREGULLIMIT DHE RISTRUKTURIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FORTESË

Numri i Prokurimit: 623-20-4677-5-1-1

Numri i Brendshëm: 623-20-039-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Vazhdimi i rregullimit dhe rristrukturimit të shtratit të lumit Rimnik në Fortesë**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Vendi i ekzekutimit të punëve është: **Në fshatin Fortesë – Komuna e Rahovecit.**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **508,862.94 €**

[Pesëqindetë mije e tetëqindëgjashtëdhjetë Euro e nëntëdhjetëkatër Cent]

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet





4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqip]¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues:			
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Smajl Latifi
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ / Kryetari i Komunës së Rahovecit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2020	Data:	05.11.2020
Vula:		Vula:	

Për Kontraktuesin:	
Emri:	Albin Thaqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2020
Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “**Punë**” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “**Kontraktuesi**” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “**Menaxheri i Projektit**” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “**Çmimi Kontratës**” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “**Vendi i ndërtimit**” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “**Pajisjet e kontraktuesit**” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “**Skicat**” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “**KPK**” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me

rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 86 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i

urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të reziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do ti zbatojë, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmerret para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrers dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse

Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbyshjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimi do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmoret se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 **Pagesa**

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do të paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 **Paramasa dhe Paralogaria**

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 **Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumën e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumën që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shumën proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 **Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogaritëse përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFJEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesëshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimin përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezuluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 24 muaj + 30 ditë , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definiuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimin të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 24 muaj .

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A – ja.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion nga një bankë e licencuar në Kosovë, ose Kompani e sigurimesh e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve do të jetë: 24 muaj . Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtesise.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
VAZHDIMI I RREGULLIMIT DHE RISTRUKTURIMI I SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FORTESË**

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbetan në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve.


Punishtja të shenjzohet dhe të vendosen labela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashih edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

A VAZHDIMI I RREGULLIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+000.00-576.80					
1 PUNËT PËRGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
1.1	Ndërtimi i kantierit dhe mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues.	Komplet	1.00	2,000.00	2,000.00
1.2	Sinjaltizimi i punishtës (sipas standardeve të ndërtimit), hyrje dalje në punishta, rrugët për qasjen dhe qarkullimin e materialeve, duke parapar edhe montimin e tabelës informuese (llamarinës dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë) me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit, vlera e investimeve, data e fillimit të punimeve si dhe data e mbarimit të punimeve. Në çmim të merren parasysh edhe shenjat lajmeruese për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë.	Komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
1.3	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj lumi si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	576.80	0.30	173.04
1.4	Hulumtimi dhe pastrimi i terrenit, trënimi i gërmadhëve dhe mbeturinave, prerja e drunjëve, cungave të ndryshëm, shkurrave të vjetra si dhe pastrimi i lokacionit për ndërtimet e reja. Në çmim të kalkulohet pastrimi komplet trases ndërtuese me ngarkim dhe transporti deri në deponin më të afërt të caktuar nga organi mbikëqyrës (në të dy anët e lumit).	m²	6,921.60	0.20	1,384.32
1.5	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore. Në rastin e paraqitjes së instalimeve nëntokësore, punmarrësi duhet të hartoj planin detaj për zgjidhjen e problemeve. Zgjidhja e dhënë aprovohet nga organi mbikëqyrës dhe i bashkangjitet projektit detaj. Në çmim të llogaritet përpilimi i planit dhe shpenzimet e tjera. Instalimet nënkuptojn (rjeti elektrik, ujsjellesin, kanalizimin, ujitjes, etj).	m'	576.80	0.20	115.36
1.6	Zhvendosja dhe rivendosja e shtyllave elektrike me të gjitha elementet e nevojshme, të cilat pengojë trasen e re të lumit. Vërejtje: Rivendosja e shtyllave elektrike duhet të bëhet mbrapa ose para lumit të rregulluar.	Copë	4.00	78.00	312.00
1.7	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencen e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	m'	576.80	0.30	173.04
1.8	Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryerjes së punëve ndërtimore (sipas nevojës).	Orë	40.00	3.00	120.00
1.9	Thyrja e pjesëve të betonit para shtëpive dhe transporti i tyre deri në deponinë më të afërt deri në 5 km ku e cakton organi Mbikëqyrës, dhe kthyerja në gjendjen e mëparshme.	m²	42.30	5.00	211.50
1.10	Dislokimi i gypit PEHD Ø450 të ujitjes i cili tregon nëpër pjesë të trasesë, në çmim duhet kalkuluar gypin e ri me pjesë fazonike të nevojshme për këto lloje të punimeve.	m'	30.00	30.00	900.00
1.11	Pastrimi, dhe largimi i të gjitha mbetjeve, demolimi i venpulishtës, dhe të gjitha mbetjet tjerë të pa nevojshme të cilat vlerësohen nga organi mbikëqyrës, pas përfundimit të punimeve.	m'	576.80	1.00	576.80
TOTALI POSICIONI:1					6,966.06


PLURAL

2 PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
2.1	Gërmimi i dheut (baltës) në fundin e lumit dhe gërmimi i humusit në brigjet e lumit t=20cm. Në çmim të llogaritet transportimi deri në deponin e përcaktuar nga Organi mbikqyrës në largësi deri në 10 Km.	m ³	997.6	0.30	299.28
2.2	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) dhe materialeve tjera me makinë, në vendpunim, në tërë sipërfaqen e profilave të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponi në më të afërt, të caktuar nga organi mbikqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëhoqëse të organit mbikqyrës.	m ³	5,486.8	0.30	1,646.04
2.4	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i thyer fraksion 0-63 mm, sipas profileve tërthore me shtresa me trashësi d=25 cm duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues.	m ²	1,247.0	4.00	4,988.00
2.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit fraksion 0-31.5 mm sipas profileve tërthore me trashësi d=20 cm në gjendje të ngjeshur. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për planifikim në teren të pjerrët. Gjithnjë sipas detaleve në projekt.	m ²	997.6	4.50	4,489.20
2.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gjeotekstilit nën zhavorin e granular 300gr/m ² (vendosja sipas detalit).	m ²	4,988.0	1.00	4,988.00
2.9	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dheut (materialit mbushës) nga deponia e dheut të cilën e cakton organi mbikqyrës (me dhe kualitativ). Në çmim duhet të llogaritet; gropimi në deponi, transporti deri në trasë, shpërndarja, ngjeshja e dheut deri në trusninë natyrale (nëse duhet edhe të laget me ujë, ose edhe të thahet), planifimi i tij dhe ngjeshje 60 MN/m ² me CBR>5%.	m ²	1,371.70	0.50	685.85
2.11	Fornizimi i skarpave dhe i fundit të shtërimit të lumit sipas vizatimit me saktësi prej (+,-) 3 cm dhe gjuajtja e dheut dhe ngjeshja me mjetet e transportit.	m ²	8,004.0	0.50	4,002.00
2.12	Gjelbrimi i skarpave të argjinaturave si dhe të gjithë sipërfaqës që është paraparë për mbrojtje. Së pari shpërndahet një shtresë e humusit 8-10cm. Kjo shtresë planifikohet dhe ngjeshet me cilindër. Në këtë shtresë hudhet farë e barit. Në çmim të kalkulohet furnizimi transporti dhe mbjellja e barit. Punimi të bëhet sipas detaleve në projekt.	m ²	3,074.0	1.00	3,074.00
TOTALI POSICIONI:2					24,172.37
3 PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
3.1	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi i pllakës së shtratit të lumit me beton të armuar hidroteknik C-25/30, me trashësi të pllakës t=15cm, me dimensione sipas detaleve në projekt.	m ³	748.2	46.00	34,417.20
3.2	Furnizimi, transporti, përgatitja, kallëpimi shkallëve me beton të armuar të klasës C-20/25. Në çmim të kalkulohet edhe armatura për shtangim, sipas detalit në projekt. Shkallët të vendosne në distanca çdo 150 m'.	m ²	16.2	50.00	810.00
3.3	Punimi dhe mbushja e fugave të diletimit, me material adekuat për fuga. Në ndajën detetuese, vendoset dërrasa me gjerësi 20 cm dhe trashësi 1.5-2 cm në të cilën llogaritet edhe llajsna e stiroporit (druirit) me trashësi t=2 cm (e cila, pas betonimit largohet në mënyrë që zbrasësira e mbetur, të mbushet me masën diletuese). Fugat vendosen në çdo 6 m'.	Copë	96.0	2.50	240.00
3.4	Furnizimi, transporti, lakimi dhe montimi i armaturës. Çmimi përfshin furnizimin, transportimin, prerjen, lakimin, montimin e shufrave të çelikut. Armimi të bëhet sipas detaleve të projektit.				
3.4.1	Armatura rrethë Q-335 (Ø8 /15/15)	kg	33,937.1	0.70	23,755.97
TOTALI POSICIONI:3					59,223.17
4 PUNËT TJERA-Rregullimi i kyqjes së degës në Lumin e rregulluar					
Sqarim: Dega e përroit e cila bashkohet me lumin e rregulluar duhet të kyqet të modifikohet dhe të pershtate me lumin e rregulluar.					
4.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III-të dhe të IV-të, dhe transporti i dheut në tërësi deri në deponi të caktuar nga organi mbikqyrës.	m ³	380.00	0.30	114.00

4.2	Mbushja, shpërndarja dhe ngjeshja (kompaktësimi) i dheut në shtresa (20-30cm) nëpër kanalit e gërmuar, sipas detaleve në projekt.	m ³	114.00	0.30	34.20
4.3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja (kompaktësimi) i zhavorit (0-31) mm nën pllaken e betonit të kanalit me trashësi 20 cm në tërë gjatësinë e tij.	m ²	36.10	7.00	252.70
4.4	Betonimi i pllakës së poshtme dhe mureve anësore të kanalit me beton C 20/25 me trashësi sipas detajeve të projektit nga llogaria statike. Çmimi për njësi përfshin: Sigurimin, transportimin, kallëpimin, vuarjen në vepër, si dhe ekzaminimin e mostrave nga ana e laboratorëve përkatës.	m ³	90.25	46.00	4,151.50
4.5	Armimi i pozitave të betonit të armuar sipas detaleve të armaturës. Çmimi për njësi përfshin: Furnizimin transportimin, prejjen, lakimin, montimin e shufrave të çelikut. Armatura duhet të vendoset në kanal sipas vizatimeve nga llogaria statike. Pozicioni të shprehet në vlerën totale në kg.				
4.5.1	Armatura rrethë Q-335 (Ø8 /15/15)	kg	3,361.05	0.70	2,352.74
TOTALI POSICIONE:3					6,905.14
REKAPITULLIM					
A	VAZHDIMI I RREGULLUMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+000.00-576.80				SHUMA TOTALE
1	PUNËT PËRGADITORE				6,966.06
2	PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT				24,172.37
3	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT				59,223.17
4	PUNËT TJERA-Rregullimi i kyqjes së degës në Lumin e rregulluar				6,905.14
TOTALI A:					97,266.74




B RISTRUKTURIMI I SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+576.80-1+419.44					
1 PUNËT PREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
1.3	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë lumi si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	842.64	0.30	252.79
1.4	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore. Në rastin e paraqitjes së instalimeve nëntokësore, punëmarresni duhet të hartoj planin detal për zgjidhjen e problemeve. Zgjidhja e dhënë aprovohet nga organi mbikqyrës dhe i bashkangjitet projektit detal. Në çmim të llogaritet perçilimi i planit dhe shpenzimet e tjera. Instalimet nënkuptojn (rjeti elektrik, ujsjellesin, kanalizimin, ujitjen etj).	m'	842.64	0.30	252.79
1.5	Hulumtimi dhe pastrimi i terrenit, rrënimi i gërmadhëve dhe mbeturinave, prerja e drunjëve, cungava të ndryshëm, shkurrave të vjetra si dhe pastrimi i lokacionit për ndërtime të reja. Në çmim të kalkulohet pastrimi komplet trases ndërtuese me ngarkim dhe transporti deri në deponin më të afërt të caktuar nga organi mbikqyrës (në të dy anët e lumit).	m ²	11,796.96	0.30	3,539.09
1.6	Zhvendosja dhe rivendosja e shtyllave elektrike me të gjitha elementet e nevojshme, të cilat pengojë trasen e rrugës. Verejtje: Rivendosja e shtyllave elektrike duhet të bëhet mbrapa ose para lumit të rregulluar.	Copë	4.00	80.00	320.00
1.7	Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryeqes së punëve ndërtimore (sipas nevojës).	Orë	20.00	3.00	60.00
1.8	Devijimi i shtrati të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencën e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	m'	842.64	0.30	252.79
1.10	Demolimi i rjetit ekzistues të kanalizimit fekal. Në çmim të kalkulohet demolimi i pusëve nga betoni, gypave, kapakëve nga betoni dhe elementeve tjera përcjellëse. Të bëhet ngarkimi dhe transporti i tyre deri në deponin e caktuar nga Organi Mbikqyrës.	m'	872.00	2.00	1,744.00
1.11	Riparimi i të gjithë gypave ekzistues në rastet e dëmtimeve të ndryshme dhe këtimi në gjendjen e mëparëshme.	Komplet	1.00	2,000.00	2,000.00
1.12	Demolimi me kujdes i rrasave nga guri me trashësi t=5 cm në pjesët ku do të ekzekutohet kanalizimi fekal. Në çmim të llogariten komplet shtresat e zhavorit dhe materialet tjera. Çmimi për sipërfaqe të rrasave.	m ²	1,300.80	0.50	650.40
1.13	Pastrimi, dhe largimi i të gjitha mbetjeve, demolimi i vanpunishtes, dhe të gjitha mbetjet tjerë të pa nevojshme të cilat vlerësohen nga organi mbikqyrës, pas përfundimit të punimeve.	m'	842.64	0.50	421.32
1.14	Pas përfundimit të punimeve të bëhet pastrimi i lumit ekzistues nga materialet e ngurta, sendimentet, mbeturina të amvisëris, prerja e barit në skarpatet ekzistuese dhe materiale të tjera inerte nga shtrati i lumit ekzistues duke përfshirë dhe transporti në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës.	m'	1,200.00	0.50	600.00
TOTALI POSICIONI 1:					10,093.18




2 PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
2.1	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) dhe materialeve tjera me makinë, në vendpunim, në tërë sipërfaqen e profileve të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponi në më të afërt, të caktuar nga organi mbikqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëhëqëse të organit mbikqyrës.	m ³	2.032.80	0.30	609.84
2.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit 0-31.5 mm sipas profileve tërthore me trashësi d=20 cm në gjendje të ngjeshur. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për planifikim në teren të pjerrët. Gjithnjë sipas detaleve në projekt.	m ³	260.16	6.00	1.580.96
2.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gjeotekstilit nën zhavorin e granular 300gr/m ² (vendosja sipas detalit).	m ²	1,300.80	1.20	1.560.96
2.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dheut (materialit mbushës) nga deponia e dheut të cilën e cakton organi mbikqyrës (me dhe kualitativ). Në çmim duhet të llogaritet: gropimi në deponi, transporti deri në trasë, shpërndarja, ngjeshja e dheut deri në trusinë natyrale (nëse duhet edhe të laget me ujë, ose edhe të thahet), planifikimi i tij dhe ngjeshja 60 MN/m ² me CBR>5%.	m ³	508.20	0.50	254.10
2.5	Fornimi i skarpave dhe i fundit të shtratit të lumit sipas vizatimit me saktësi prej (+, -) 3 cm dhe gjuajtja e dheut me mjetet e transportit.	m ²	5,353.20	0.30	1,605.96
2.6	Gjelbrimi i skarpave. Së pari shpërndahet një shtresë e humusit 8-10cm. Kjo shtresë planifikohet dhe ngjeshet me cilindër. Në këtë shtresë hudhet farë e barit. Në çmim të kalkulohet furnizimi transporti dhe mbjellja e barit. Punimi të bëhet sipas detaleve në projekt.	m ²	4,568.40	0.70	3,197.88
TOTALI POSICIONI 2:					8,789.70
3 PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtratit të lumit në pjesët e pjanta (skarpave) dhe bazës së lumit me rrasa gurë me trashësi minimale t=8.0cm dhe mbushja e fugave me ilaç çimentoje 1:3:9. Vendosja e gurëve rrasor bëhet në shtresë betoni C-25/30 t=10cm. (Ekzekutimi sipas detaleve në projekt).	m ²	1,550.96	12.00	18,731.52
TOTALI POSICIONI 3:					18,731.52
4 PUNIMI I MURIT MEROJTËS L=60.0 m'					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
4.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III dhe IV për hapjen e themeleve të mureve mbrojtëse dhe barije e materialit gërmues deri në deponiri e caktuar nga organi mbikqyrës.	m ³	99.00	0.30	29.70
4.2	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e zhavorit me fraksion 0-63mm nën bazamentin e themeleve të mureve mbrojtëse me trashësi t=25cm pas ngjeshjes së saj.	m ³	23.40	6.00	140.40
4.3	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e zhavorit me fraksion 0-32mm nën bazamentin e themeleve të mureve mbrojtëse me trashësi t=15cm pas ngjeshjes së saj.	m ³	14.04	7.00	98.28
4.4	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e betonit të varfer nën bazamentin e themelit të mureve mbrojtëse me trashësi t=5cm dhe rafshimi i sajë.	m ³	3.60	5.00	18.00
4.5	Furnizimi, transporti kallupimi dhe betonimi i themeleve dhe mureve mbrojtëse, gjithmonë duke u bazuar në detale të kallupimit, armimit dhe specifikim të armatës të bashkangjitura në projekt. Betoni C 25/30. Në mure mbrojtëse në nivelin e poshtëm duhet që të lihen vrimat gjdo 1m' për kullimin e ujrave nëntokesor.	m ³	48.00	49.00	2,352.00
4.6	Furnizimi, transporti, lakimi dhe vendosja në vepër e pozicioneve të armatës të mureve mbrojtëse si në projekt (të shikohen detalet e armimit dhe specifikimi i armatës të mureve mbrojtëse). Armatura me klasë S500.	kg	3,360.00	0.70	2,352.00
4.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gypit drenazhues Ø160 të mbeshjelluar me gjeotekstil prapa murit mbrojtës si dhe pas vendosjes së gypit të mbyllet me zhavor të pastër kokëzror për drenazhim në lartësi min. 50cm mbi nivelin e gypit me gjeresi horizontale mesatare 0.7m.	m'	60.00	10.00	600.00

S.H.P.K.

4.7	Punimi dhe mbushja e fugave të diletimit, me material adekuat për fuga. Në ndarjen deletuese, vendoset dërasa me gjerësi 20-30 cm dhe trashësi 1.5-2 cm në të cilën llogaritet edhe llajsa e stroponit (drurit) me trashësi t=2 cm (e cila, pas betonimit largohet në mënyrë që zbrasësira e mbetur, të mbushet me masën diletuese). Fugat vendosen në çdo 12 m'	Copë	5.0	50.00	250.00
TOTALI POSICIONI 4:					5,840.38
REKAPITULLIM					
B RISTRUKTURIMI I SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+576.80-1+419.44					
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	SHUMA TOALE			
1	PUNËT PREGADITORE	10,093.18			
2	PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT	8,789.70			
3	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT	18,731.52			
4	PUNIMI I MURIT MBROJTËS L=60.0 m'	5,840.38			
TOTALI B :					43,454.78
C VAZHDIMI I RREGULLIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 1+419.71-1+672.34					
1 PUNËT PREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
1.1	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj lumi si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	452.90	0.30	135.87
1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore. Në rastin e paraqitjes së instalimeve nëntokësore, punëmarrasi duhet të hartoj planin detal për zgjidhjen e problemeve. Zgjidhja e dhënë aprovohet nga organi mbikqyrës dhe i bashkangjitet projektit detal. Në çmim të llogaritet perçilimi i planit dhe shpenzimet e tjera. Instalimet nënkuptojn (rjeti elektrik, ujsjellësin, kanalizimin, ujitjen etj).	m'	423.00	0.30	126.90
1.3	Hulumtimi dhe pastrimi i terrenit, rënimi i gërmadhave dhe mbeturinave, prerja e drunjëve, cungave të ndryshëm, shkurrave të vjetra si dhe pastrimi i lokacionit për ndërtime të reja. Në çmim të kalkulohet pastrimi komplet trases ndertuese me ngarkim dhe transporti deri në deponin më të afërt të caktuar nga organi mbikqyrës (në të dy anët e lumit).	m ²	6,776.10	0.20	1,355.22
1.4	Zhvendosja dhe rivendosja e shtyllave elektrike me të gjitha elementet e nevojshme, të cilat pengojnë trasen e lumit. Verejtje: Rivendosja e shtyllave elektrike duhet të bëhet mbrapa ose para lumit të rregulluar.	Copë	5.00	80.00	400.00
1.5	Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryerjes së punëve ndertimore (sipas nevojës).	Orë	35.00	3.00	105.00
1.6	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencën e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	m'	452.90	0.30	135.87
1.7	Riparimi i të gjithë gypave ekzistues në rastet e demtimeve të ndryshme dhe kthimi në gjendjen e mëparëshme.	Komplet	1.00	500.00	500.00
1.8	Pastrimi, dhe largimi i të gjitha mbetjeve, demolimi i venpunishtes, dhe të gjitha mbetjet tjerë të pa nevojshme të cilat vlerësohen nga organi mbikqyrës, pas përfundimit të punimeve.	m'	452.90	0.50	226.45
TOTALI POSICIONI 1:					2,985.31
2 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
2.1	Gërmimi i dheut (baltës) në fundin e lumit dhe gërmimi i humusit në brigjet e lumit t=20cm. Në çmim të llogaritet transportimi deri në deponin e përcaktuar nga Organi mbikqyrës në largësi deri në 10 Km.	m ³	1,506.0	0.30	451.80




2.2	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) dhe materialeve tjera me makinë, në vendpunim, në tërë sipërfaqen e profileve të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponi në më të afërt, të caktuar nga organi mbikqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëhoqëse të organit mbikqyrës.	m ²	11,012.6	0.30	3,303.78
2.4	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i llyer fraksion 0-63 mm, nën themelet e mureve mbrojtëse dhe nën pllakën e poshtme të lumit sipas profileve tërthore me shtresa me trashësi d=25 cm duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues. Punimi të bëhet sipas detaleve në projekt.	m ²	1,637.8	5.00	8,189.00
2.5	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e zhavont me fraksion 0-32mm nën bazamentin e themeleve të mureve mbrojtëse dhe pllakës së lumit me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur. Punimi të bëhet sipas detaleve në projekt.	m ²	1,310.2	7.00	9,171.40
2.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gypit drenazhues Ø160 të mbeshjtelluar me gjeotekstil prapa muri mbrojtës si dhe pas vendosjes së gypit të mbyllet me zhavor të paster kokerzor për drenazhim në lartësi min. 100cm mbi nivelin e gypit me gjeresi horizontale mesatare 0.6m.	m ¹	910.0	10.00	9,100.00
2.7	Furnizimi me material, transporti dhe mbushja e sipërfaqeve prapa mureve mbrojtës me material mbushës si dhe të bëhet ngjeshja e sajë në shtresa çdo 20cm.	m ²	6,795.00	0.30	2,038.50
2.8	Formimi i skarpave dhe i fundit të shtratit të lumit sipas vizalimit me saktësi prej (+,-) 3 cm dhe gjuajtja e dheut dhe ngjeshja me mjetet e transportit.	m ²	13,102.20	0.20	2,620.44
TOTALI POSICIONI 2:					34,874.92



3 PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT DHE MUREVE MBROJTËSE					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
3.1	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e betonit të varfër në bazamentin e themelit të mureve mbrojtëse me trashësi t=5cm dhe rafshimi i sajë.	m ³	120.48	5.00	602.40
3.2	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi i pllakës së shtratit të lumit me beton të armuar hidroteknik C-25/30, me trashësi të pllakës t=10cm, me dimensione sipas detaleve në projekt.	m ³	421.68	50.00	21,084.00
3.3	Furnizimi, transporti kallupimi dhe betonimi i themeleve dhe mureve mbrojtëse, gjithmonë duke u bazuar në detale të kallupimit, armimit dhe specifikim të armatures të bashkëngjitura në projekt. Betoni C 25/30. Në mure mbrojtëse në nivelin e poshtëm duhet që të lihen vrimat gjdo 1m' për kullimin e ujrave nëntokesor.	m ³	2,439.72	45.00	109,787.40
3.4	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armatures sipas detaleve në projekt për të gjitha elementet e kanalit, me klas S-400/500. Në çmim të kalkulohet komplet për kg.				
3.4.1	Armatura e brinjëzuar S-400/500	kg	182,979.00	0.15	27,446.85
3.4.2	Armatura rrjetë Q-335 (Ø8 /15/15)	kg	27,076.89	0.60	16,246.13
3.5	Punimi dhe mbushja e fugave të diletimit, me material adekuat për fuga. Në ndarjen deletuese, vendoset dërasa me gjerësi 25-40 cm dhe trashësi 1.5-2 cm në të cilën llogaritet edhe lajsna e stiroporit (drurit) me trashësi t=2 cm (e cila, pas betonimit largohet në mënyrë që zbrasësira e mbetur, të mbushet me masën diletuese). Fugat vendosen në çdo 12 m'.	Copë	72.0	5.00	360.00
TOTALI POSICIONI:3					175,526.78
REKAPITULLIM					
C VAZHDIMI I RREGULLUMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESE ST: 1+419.71-1+872.34					
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	SHUMA TOTALE			
1	PUNËT PREGADITORE	2,985.31			
2	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT	34,874.92			
3	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT DHE MUREVE MBROJTËSE	175,526.78			
Gjithsej B :					213,387.01
D KOLEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA					
1	PUNËT PREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
1.1	Përgaditja dhe pastrimi i trasës së kanalit nga drunjet, shkurret dhe elementet tjera që pengojnë në implementimin e projektit.	m'	3,100.00	0.20	620.00
1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizikë i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	3,100.00	0.30	930.00
TOTALI POSICIONI:1					1,550.00
2	PUNËT E GËRMIMIT DHE ZHAVORIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
2.1	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV me makinë dhe me dorë për ndërtimin e kanalit për vendosjen e gypave me gjerësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor. Thellësia mesatare h=2.00 m. Llogaria në m ³ të dheut të gërmuar.				
2.1.1	- Me makinë 90 %	m ³	10,850.00	0.30	3,255.00
2.1.2	- Me dorë 10 %	m ³	1,065.00	0.30	325.50
2.3	Planifikimi me dorë i fundit të kanalit pas gërmimit sipas pjertësis së projektuar, në saktësi ±1 cm.	m ²	3,100.00	0.10	310.00
2.4	Sigurimi i kanalit nga shembjet e dheut. Sigurimi bëhet me pahë të parapar sipas normave për këtë llojë pune, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet në tërë gjatësinë e kanalit nëse thellësia është më e madhe se 1.5m për shkak të sigurisë së puntorëve.	m ²	2,600.00	0.20	520.00

SH.P.K
PLURAL

2.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës Ø (4-8) mm në kanal, ashtu që së pari të ndërtohet baza prej 15-20 cm varesisht nga diametri i gypit sipas detajeve të dhëna, ndërsa pas montimit të gypit të hudhet rëra përreth dhe mbi gyp 15 cm.	m ³	2,090.64	1.50	3,135.96
2.6	Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me dhe të gërmuar dhe ngjeshja në shtresa prej 30 cm deri në kuotën e terrenit.	m ³	9,844.36	0.20	1,968.87
2.7	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepër) deri në deponi të qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri 10 km.	m ³	2,090.64	0.30	627.19
2.8	Furnizimi dhe shtrija e shiritit paralajmruar (sinjalizues).	m	3,100.00	0.20	620.00
2.9	Largimi i ujrave nëntokësor me pompa nëse ato paraqiten. Llogaria bëhet në orë efektive të punës së pompës të cilat duhet ti përcjell dhe miratoj organi mbikqyrës	Orë	20.00	2.00	40.00
TOTALI POSICIONI:2					10,802.52



3 PUNËT E MONTUESE					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
3.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të kanalizimit fekal të llogaritur. Gypat duhet të montohen sipas kushteve teknike të egzekutimit dhe duhet tu jipet pjerësia e projektuar dhe e njëjta të verifikohet aty për aty me nivelë. Si dhe lidhja e tubit kokë-kokë të bëhet me vendosjen e rrethit izolues ose "diktum"-it Gypat duhet të jenë të prodhuar sipas standartit EN 13476-3 dhe ISO 9969				
3.1.1	Gypa PEHD-SN8 Ø400 mm (Standarti EN 13476-3 dhe ISO 9969)	m'	3,100.00	14.00	43,400.00
TOTALI POSICIONI:3					43,400.00



4 PUNËT E BETONIT					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e befoarnes në pllakën e poshtme të pusetave me beton arme C-20/25, çelik rrethë Ø8.5 10/10 cm dhe trashësia d=20cm. Të llogaritet komplet bazamenti i pusetes, për kubik të betonit.	m ³	39.20	5.00	196.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për kineta me përpunim sipas detalit.	m ³	7.84	8.00	62.72
4.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave(për puseta) prej betonit të armuar Ø 1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	Copë	240.00	25.00	6,000.00
4.4	Furnizimi transporti dhe montimi i konuseve për puseta prej betoni Ø1000/700/500mm (elemente të parafabrikuara).	Copë	100.00	55.00	5,500.00
4.5	Punimi dhe montimi i shkalleve prej çeliku me lyrje antikorozive, në çdo 20 cm duke i përforcuar në beton.	Copë	860.00	2.50	2,150.00
4.6	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve nga materiali "KOMPOZIT", sipas standarteve ISO-9001 dhe ISO 14001 me aftësi mbajtëse 15 Ton. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	Copë	10.00	50.00	500.00
4.7	Furnizimi transporti dhe montimi i kapakëve të pusetave, nga materiali beton arme me klase të betonit C-25/30, me trashësi t=12 cm. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betoarmesë c-25/30	Copë	90.00	20.00	1,800.00
4.8	Kyçja e kanalizimeve dhe objekteve ekzistuese në kolektorin e projektuar.	Copë	54.00	30.0	1,620.00
4.9	Punimi i kokës shkarkuese në lumë sipas detalit në vizatim. Në çmim të llogaritet, furnizimi, transporti dhe betonimi i betonit C25/30 dhe armatura rrethë Ø-2*188.	Copë	1.00	300.0	300.00
4.10	Furnizimi , transporti dhe montimi i mbyllesit kapak (Flap valve) Ø400 mm.	Copë	1.00	150.0	150.00
4.11	Testimi i rrejtë të kanalizimit. Me përfundimin e montimit para mbulimit të kanalit të bëhet testimi hidraulik i kolektorëve në presion provues sipas udhëzimeve të prodhuesve të gypave dhe pjesëve fazonike dhe në pajtim me kushtet teknike të ekzekutimit dhe në prezencën e organit mbikqyrës.	m'	3,100.00	0.50	1,550.00
4.12	Kthimi i terrenit në gjendjen ekzistuese. Pastrimi i terrenit dhe largimi i të gjitha materialeve të mbetura gjatë ekzekutimit të punimeve.	m'	3,100.00	0.50	1,550.00
TOTALI POSICIONI:4					21,378.72

REKAPITULLIM

D KOLEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA

Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	SHUMA TOTALE
1	PUNËT PREGADITORE	1,550.00
2	PUNËT E GËRMIMIT DHE ZHAVORIT	10,802.52
3	PUNËT E MONTUESE	43,400.00
4	PUNËT E BETONIT	21,378.72
Gjithsej C :		77,131.24

REKAPITULLIM

Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i shtratit të Lumit Rimnik në Fortesë

POZ.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	SHUMA TOTALE
A	VAZHDIMI I RREGULLIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+000.00-576.80	97,266.74
B	RISTRUKTURIMI I SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 0+576.80-1+419.44	43,454.78
C	VAZHDIMI I RREGULLIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT RIMNIK NË FSHATIN FORTESË ST: 1+419.71-1+872.34	213,367.01
D	KOLEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA	77,131.24
Gjithsej pa TVSH :		431,239.78
TVSH(18%) :		77,623.16
Gjithsej me TVSH :		508,862.94

